



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1503/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbarimore të kreditorit Aydin Guçsan Makinasany Ticaret LDT.STI me seli në Aydin Turqi, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve J..., me seli Prishtinë, kundër debitorit Lirigzoni Sh.p.k. Zona Industriale Kosova me NRB 71134881, përfaqësuar nga K.O, avokat nga Mitrovica, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.407/21, të datës 11.10.2021, i caktuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET I BAZUAR prapësimi i debitorit Lirigzoni sh.p.k. Zona Industriale Kosova me NRB 71134881, ANULOHET urdhri përmbarimor P.nr.407/21 i datës 11.10.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimi si dhe taksës gjyqësore për prapësim, t'ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme prej EUR 176.00 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të përfaqësuesit të kreditorit Aydin Guçsan Makinasany Ticaret LDT.STI me seli në Aydin Turqi, mbi bazën e dokumentit të besueshëm – Faturës me numër 000865123, e datës 15.09.2021, ka caktuar përmbarimin me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 407/21 të datës 11.10.2021, me të cilin urdhërohet debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës të sipërsënuar në shumë totale prej 65,000.00 Euro me kamatë 8% sipas LMD-së si dhe shpenzimet e tjera të

krijuara, shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me UA-MD-së Nr.06/2014, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Kundër këtij urdhri, në afat ligjor, prapësim ka paraqitur debitori me të cilën e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetimin se faturat nuk janë të nënshkruara as të vulosura nga ana e debitorit, dhe se nuk burojnë nga asnjë borxh kontraktual ngase kreditori nuk i është përmbajtur marrëveshjes kontraktuale pasi që sipas saj është dashur të sjell komplet makinerinë për thërrmimin e gurit, ndërsa kreditori ka dështuar që ti sjellë komplet makinerinë dhe të bëjë montimin e saj. Shton se makineria është sjell nga ana e kreditorit, është doganuar në emër të Guri Company sh.p.k me seli në Shtime. Pohon se ka paguar këstet në vlerë prej 100.000.00 euro, ndërsa pagesa e mbetur prej 65,00.00 të cilën e kërkon kreditori nuk i detyrohen sepse nuk e ka përmbushur marrëveshjen për mullirin terciar për thërrmimin e gurit në vlerë prej 45,000.00 euro dhe montimi në vlerë prej 20.000.00. Gjykatës i propozoi të aprovohet prapësimi dhe urdhri përbarimor të ndalohet në tërësi dhe të obligohet kreditori që ti paguaj shpenzimet e procedurës, shpenzimet për taksa gjyqësore dhe shpenzimet tjera.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se debitori dhe kreditori kanë pas marrëveshje për blerjen e makinerive. Sqaron se me 12 maj 2018, ata lidhën një kontratë që përcaktonte të drejtat dhe detyrimet e tyre në mënyrë reciproke në atë mënyrë që detyrimi për pagesë ishte 120,000.00 euro dhe debitori u zotua që këtë shumë ta paguaj në tre këste nga 40,000.00 euro, ku kësti i fundit ishte i paguar më 1 prill 2019. Shton se kreditori ka kërkuar vazhdimisht nga debitori që të përmbushë detyrimin, mirëpo, meqenëse debitori nuk e ka përmbushur këtë detyrim, kreditori ka dërguar një faturë të përmbledhur për borxhin e mbetur më 12 shtator 2021, siç është specifikuar në kontratën e datës 12 gusht 2018 dhe se kjo faturë është dërguar edhe me email. Sipas kreditorit, ky veprim plotëson të gjitha kushtet ligjore për lejimin e përbarimit. Tutje thekson se debitori nuk ka përmendur asnjëherë nga shkaqet me prapësimin të përcaktuara në nenin 71 të LPP-së dhe se pretendimet e debitorit janë të pabazuara dhe vetëm me qëllim të zvarritjes së procedurës. Nga gjykata ka kërkuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të vërtetoj urdhrin përbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPPsë i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”* Gjykata vlerëson se në rastin konkret - Fatura me numër 000865123, e datës 15.09.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – Fatura me numër 000865123, e datës 15.09.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se njëjta është pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë tjetër. Gjykata vlerëson se e-maili i dërguar nga kreditori tek debitori nuk është provë e mjaftueshme se fatura është pranuar. Në mungesë të konfirmimit të faturës së pranuar nga debitori përmes emailit që i është dërguar nga kreditori, pretendimi i tillë duhet të refuzohet.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë

edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbauesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbaimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitorit në emër të prapësimit të ushtruar, në vlerë prej EUR 156.00, konform rregullores në fuqi për tarifatat e avokatëve, si dhe shumën prej EUR 20.00 në emër të taksës gjyqësor për paraqitjen e prapësimit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 1503/22, datë 28.07.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.